VENDIM
Nr. 175, datë 17.3.2021

PËR NGRITJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SPITALIT RAJONAL "MEMORIAL" NË FIER, SI PROJEKT PILOT

(ndryshuar me VKM nr. 258, datë 5.5.2021; nr. 867, datë 29.12.2021)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e spitalit rajonal "Memorial" në Fier, si projekt pilot me status të veçantë të funksionimit si spital i nivelit terciar, që ushtron veprimtarinë e tij në bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit spitalor dhe bazuar në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, të ratifikuar me ligjin nr. 23/2021, me seli në Fier, pjesë e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

2. Spitali rajonal "Memorial" në Fier do të funksionojë për një periudhë tranzitore në bashkëpunim me personat e caktuar nga ministria e shëndetësisë turke, sipas protokollit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet dy ministrave përkatës, përgjegjës për shëndetësinë.

3. Spitali rajonal "Memorial" në Fier ofron shërbimet bazë, sipas listës së shërbimeve në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Spitali rajonal "Memorial" në Fier e ushtron veprimtarinë e tij, në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokolleve të diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

5. Rregullimet e përgjithshme dhe në hollësi të veprimtarisë së spitalit rajonal "Memorial" në Fier përcaktohen në statutin e spitalit, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

6. Organet drejtuese të spitalit rajonal "Memorial" në Fier janë:

a) Bordi Drejtues i spitalit rajonal "Memorial" në Fier, si organi më i lartë ekzekutiv, i cili është i pavarur në veprimtarinë e tij dhe funksionon si organ kolegjial;

b) drejtori i përgjithshëm, i cili emërohet dhe shkarkohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

7. Bordi Drejtues kryesohet nga përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ka në përbërje:

a) 1 përfaqësues të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;

b) 1 përfaqësues të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

c) *një përfaqësues i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë;*

ç) 1 përfaqësues të Urdhrit të Mjekut.

8. Funksionet e Bordit Drejtues përcaktohen në statutin e spitalit rajonal "Memorial" në Fier.

9. Institucionet e përmendura në pikën 7 të këtij vendimi, përcaktojnë anëtarët e bordit, të cilët marrin një shpërblim për pjesëmarrje në mbledhje, masa e të cilit propozohet dhe miratohet nga Bordi Drejtues.

10. Bordi Drejtues raporton periodikisht pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

11. Rregullorja e brendshme e spitalit miratohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

12. Financimi nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore realizohet sipas paketave të shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

13. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratë me spitalin rajonal "Memorial" në Fier për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore, duke përfshirë shpenzimet për personelin, shërbimet korrente dhe paketat e shërbimeve të ofruara dhe, në bashkëpunim me Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, kontrollon e monitoron buxhetin spitalor, vlerëson aktivitetin vjetor të spitalit dhe treguesit e performancës, nëpërmjet strukturave të tyre audituese e kontrolluese, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

14. Në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, alokohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave fondi shtesë për menaxhimin dhe funksionimin e spitalit rajonal "Memorial" në Fier, në vlerën 300 000 000 (treqind milionë) lekë.

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon, nga buxheti i miratuar për vitin 2021, spitalin rajonal "Memorial", në Fier, nga të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore, me vlerën shtesë 28 400 000 (njëzet e tetë milionë e katërqind mijë) lekë.

15. Të ardhurat dytësore, të realizuara nga spitali rajonal "Memorial" në Fier, përdoren nga vetë spitali, sipas kritereve që përcaktohen në statut dhe miratohen nga Bordi Drejtues i spitalit.

16. Struktura dhe organika e spitalit miratohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, me propozim të Bordit Drejtues të spitalit.

17. Numri i punonjësve të spitalit rajonal "Memorial" në Fier për vitin 2021 është 398 veta.

18. Personeli prej 398 punonjësish i spitalit rajonal "Memorial" në Fier i shtohet numrit të punonjësve që financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të miratuar për vitin 2021.

19. Personeli i kujdesit shëndetësor turk caktohet nga Republika e Turqisë gjatë fazës së tranzicionit të spitalit rajonal "Memorial" në Fier, në zbatim të nenit 1, të marrëveshjes së lidhur, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, ratifikuar me ligjin nr. 23/2021.

20. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të spitalit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

21. Përzgjedhja e personelit mjekësor dhe administrativ shqiptar bëhet nga komisioni *ad hoc* që ngrihet me urdhër të veçantë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

22. Institucionet kompetente ushtrojnë kontroll mbi veprimtarinë e spitalit rajonal "Memorial" në Fier, sipas legjislacionit në fuqi dhe brenda fushës së tyre të përgjegjësisë.

23. Spitali rajonal "Memorial" në Fier ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: "Republika e Shqipërisë, spitali rajonal "Memorial" në Fier, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

24. Vula e spitalit rajonal "Memorial" në Fier ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e përdorimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

25. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCË NR. 1
LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

(shtuar pika 19/1 me VKM nr. 258, datë 5.5.2021)

I. SPITALI RAJONAL "MEMORIAL" NË FIER

1. Shërbimi i urgjencës;
2. Shërbimi i kardiologjisë;
3. Shërbimi i hematologjisë;
4. Shërbimi i nefrologjisë;
5. Shërbimi i gastrohepatologjisë;
6. Shërbimi i ORL-së;
7. Shërbimi i okulistikës;
8. Shërbimi i pneumologjisë;
9. Shërbimi i neurologjisë;
10. Shërbimi i urologjisë;
11. Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme;
12. Shërbimi i ortopedisë dhe i traumatologjisë;
13. Kirurgjia torakale;
14. Shërbimi i neurokirurgjisë;
15. Shërbimi i kirurgjisë vaskulare;
16. Shërbimi i anestezi-reanimacionit;
17. Shërbimi i sëmundjeve infektive;
18. Shërbimi i radiologjisë;
19. Shërbimi i fizioterapisë;

19/1. Shërbimi i laboratorëve (klinikë-biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, atomopatologjikë, gjenetikë mjekësorë, laboratori i mjekësisë nukleare);

20. Farmacia;
21. Konsultat e specializuara ambulatore;
22. Kontrolli i infeksioneve spitalore.